



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Zyra Kryetarit



12 Nr. 060/01- 5713 dt. 31/01/2019

Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt : 31.01.2019

1. Vendim Për Aprovimin e Programit Komunal Tre vjeçar për Banim për Periudhën 2019-2021
2. Vendim Për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Komunale për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Organizatave të Biznesit në Komunën e Drenasit.
3. Vendim Për përkrahjen-subvencionimin e KRM "Pastrimi" SH.A



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës


12 Nr. 060/01-5713 dt. 31/01/2019



Nga :Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- z.Labinot Halilaj

Për: Kryetarin e Komunës z.Ramiz Lladrovci

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt : 31.01.2019



1. Vendim Për Aprovimin e Programit Komunal Tre vjeçar për Banim për Periudhën 2019-2021
2. Vendim Për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Komunale për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Organizatave të Biznesit në Komunën e Drenasit.
3. Vendim Për përkrahjen-subvencionimin e KRM "Pastrimi" SH.A



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA DRENAS

Kuvendi I Komunës

12 Nr. 360-5712 dt. 31/01/2019

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe nenin 40 pika 40.2 nën 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Memorandumit të Mirëkuptimit Nr. 400/01-41583 datë 19/07/2018, Vendimit Nr.01 400-51039 të dates 27/08/2018, nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithëshme Administrative, nenin 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës, Kuvendi I Komunës, në mbledhjen e vet të rregullt të mbajtur me date 31.01.2019, aprovoi këtë:

V E N D I M

Për Aprovimin e Programit Komunal Tre vjeçar për Banim për Periudhën 2019-2021

Neni I

Më këtë vendim aprovet Programi Komunal Tre vjeçar për Banim për periudhën 2019-2021, hartuar nga Grupi Punues Komunal në konsultë me OJQ – DEVELOPING TOGETHER.

Neni II

Programi ka përr qëllim identifikimin e rasteve dhe ndihmë e sigurim të banimit për kategori të ndryshme qytetarësh në nevojë për banim të përkohëshëm.

Neni III

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari I Komunës dhe Drejtoratet përkatëse të Komunës së Drenasit.

Neni IV

Ky vendim hynë në fuqi 15 nga dita e regjistrimit dhe vlersimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryetuesi I Kuvendit të Komunës
Labirnot Halilaj



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-313 - 5709 dt. 31/01/ 2019

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 pika 40.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme, Udhëzimit Administrativ nr.2007/02 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, nenin 34 pika 34.6 të statutit të Komunës si dhe kërkesës nr.04-070-68986, të datës 20.11.2018, të subjekteve që merren me veprimtarin e Barnatoreve, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt më datë 31.01.2019 aprovoi këtë:

V E N D I M

Për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Komunale për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Organizatave të Biznesit në Komunën e Drenasit

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet Plotesim ndryshimi i Rregullores Nr.12-313-5137, të dates 28.04.2013 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punes se organizatave të biznesit në komunën e Drenasit.

Neni 2

Ndryshohet neni 15 paragrafi 15.1, 15.2, i Rregullores Nr.12-313-5137, të dates 28.04.2013 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punes së organizatave të biznesit në komunën e Drenasit, dhe atë:

- a) Periudha verore, ndryshohet nga 08:00 - 20:00, në 08:00 - 21:00,
- b) Periudha dimërore, ndryshohet nga 08:00 - 20:00, në 08:00 - 19:00,
- c) Vikendeve dhe gjatë festave zyrtare do të kujdestarohet 24h, përjashtimisht në raste urgjente mund të punohet edhe jashtë orarit të paraparë më lartë.

Neni 3

Pas aprovimit të ndryshimeve të lartecaktuara do të njoftohen të gjitha subjektet e prekura dhe drejtorit përkatëse në Komunën e Drenasit.

Neni 4


Perveq paragrafit 15.1 dhe 15.2, dispozitat tjera të Rregullores Nr.12-313-5137, të dates 28.04.2013 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punes së organizatave të biznesit në komunën e Drenasit, mbesin të pa ndryshuara.

Neni 5

Pas aprovimit të plotesim ndryshimit të lartcekur, shfuqizohet Vendimi Nr.031-52786, i datës 07.09.2016, i Kuvendit të Komunes së Drenasit.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlersimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës

 **Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
Labiriot Halilaj



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr 12-400-5705 dt. 31.01 2019

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040
Neni 34 pika 34.6 të statutit të Komunës së Drenasit, pastaj buxhetit të miratuar nga Kuvendi i komunës së Drenasit për vitin 2019, si dhe në bazë të kërkesës së KRM"Pastrimi"Sh.A Prishtinë Nr.43, të dt.09.01.2019 për përkrahjen subvencionimin për pagesën e borgjit ndaj KMDK-së, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt.31.01.2019 aprovoi këtë;

VENDIM

Për përkrahjen –subvencionimin e KRM"Pastrimi"SH.A

Neni 1

Më këtë vendim aprovohet mbështetja financiare-subvencionimi për KRM"Pastrimi"Sh.A Prishtinë, lidhur me përkrahjen financiare për pagesën e borgjit ndaj Kompanisë për menagjimin e deponive në Kosovë (Deponia Regjionale Mirash).

Neni 2

KRM"Pastrimi"Sh.A do të përkrahet me shumën prej 50,405.45 euro, mjete të cilat do të shfrytëzohen për pagesën e borgjit ndaj KMDK-së

Neni 3

Financimi-subvencionimi i KRM"Pastrimi"Sh.A, do të bëhet nga buxheti i Komunës së Drenasit, nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencione dhe transfero, kodi ekonomik 611.

Neni 4

Mjetet financiare barten në konton e KRM"Pastrimi"Sh.A, Komuna e Drenasit është zotuar se obligimin në fjalë do ta përmbush me mjete financiare nga kategoria ekonomike e shpenzimeve e cekur më lartë.


Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës si dhe Drejtorati për buxhet dhe financa

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Labiriot Halilaj